



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-2466/24 datë:22.01.2024



Npi – 01/44 datë: 31.01.2024

Duke u bazuar në Nenin 12.2 pika (d), Nenin 17 pika (k), dhe Nenin 24, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/2008); Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, me shkresën Nr.07/05 të datës 24.01.2024 i propozon Kuvendit të Komunës së Shtimes që të marrë vendim për subvencionimin e veçantë për Nën-at-Lehona, për çdo lindje të fëmijës gjatë vitit 2024, për banorët e Komunës së Shtimes. Kuvendi i Komunës së Shtimes pasi analizoi propozimin e drejtorisë, në seancën e mbajtur më 31.01.2024, miratoi këtë:

V E N D I M

PËR NDARJEN E SUBVENCIONEVE PËR NËNAT-LEHONA PËR ÇDO FËMIJË TË LINDUR GJATË VITIT 2024

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e -I- të rregullt, për vitin 2024, të mbajtur më 31.01.2024, me shumicën e votave miratoi Vendimin për subvencionimin e veçantë për secilën Nënë-Lehonë, për çdo fëmijë të lindur gjatë vitit 2024, si dhe për fëmijët e lindur në vitin 2023 e të cilët nuk kanë pas mundësinë të aplikojnë për realizimin e të drejtës së tyre, gjatë vitit 2023, si vijon:

1. Fëmija i I-rë do të subvencionohet me 100 €;
2. Fëmija i II-të do të subvencionohet me 150 €;
3. Fëmija i III-të e tutje do të subvencionohen me nga 200 €;
4. Fëmijët binjakë do të subvencionohen me 500 €;
5. Fëmijët trinjakë do të subvencionohen me 1000 €;
6. Shumës prej 1000 € (për trinjakë) do t'i shtohen edhe nga 500 € për çdo fëmijë të lindur njëkohësisht më shumë se trinjakë.

II

Të drejtën mbi bazën e këtij vendimi e gëzojnë edhe të gjitha Nën-at-Lehona që nuk e posedojnë shtetësinë e Kosovës por që janë të martuara me burrat që kanë shtetësinë e Kosovës. Po ashtu edhe të gjitha Nën-at-Lehona që kanë lindur fëmijën pa shenja jete ose që pas lindjes fëmija ka ndërruar jetë.

III

Obligohet Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, që të fillojë me zbatimin e këtij vendimi, pas hyrjes në fuqi.

IV

A r s y e t i m: Vendimi i Komunës për subvencionimin e Nënave-Lehona për vitin 2024 është miratuar nga anëtarët e Kuvendit, duke marrë për bazë edhe Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa Npi-01/19 dt. 29.01.2024 si dhe Rekomandimin e Komitetit për Komunitete Npi-01/28 dt. 29.01.2024. Për ngritjen e subvencioneve në krahasim me vitin e kaluar është marrë për bazë rritja e Buxhetit të Komunës, mbi bazën e zotimeve tona për t'i ndihmuar kësaj kategorie në programin për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, pika 4 (Subvencione dhe Transfere) nga shuma 132,734 € në vitin 2023, në shumën prej 162,734 €, në vitin 2024. Subvencionimi nga vitet paraprake 2022 e 2023 është mirëpritur shumë nga të gjitha Nënat Lehona që kanë qenë përfituese për fëmijët e tyre.

V

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.

VI

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorive, Zyrës Komunale për Financa, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, Ministrisë për Financa dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit

Adnan Ademi